



## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_1094\_02\_14**;
- Ankesa e konsumatorit e datës 14.03.2014.

në seancën e mbajtur më datë 29 prill 2014, nxorri këtë:

### V E N D I M

- I **REFUZOHE**t ankesa e konsumatorit G. G. me shifër DPR 205420 nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së.
- II **MBETET** në fuqi vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_1094\_02\_14 i datës 24.02.2014.

### Arsyetim

Konsumatori me datë 24.06.2013 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në Konsumator në KEDS me të cilën ka kërkuar nga ta që të bëjë shlyerjen e borxhit të energjisë elektrike në vlerë financiare prej 429.83€, pasi që ka gjendjen e vështirë ekonomike, jeton nga ndihmat sociale dhe se kjo vlerë e borxhit të energjisë elektrike është e papërbalueshme. Arsye tjetër e konsumatorit në ankesë për shlyerjen e borxhit ka qenë pasi që si rezultat i borxhit të energjisë elektrike është duke u shqyçur nga rrjeti elektrike.

Konsumatori pas marrjes së përgjigjes së KEDS-it me datë 05.07.2013 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE duke kërkuar shlyerjen e borxhit të energjisë elektrike në vlerë financiare prej 429.83€, pasi që ka gjendjen e vështirë ekonomike, jeton nga ndihmat sociale e **refuzuar** ankesën e konsumatorit me arsyetimin se ky konsumator nuk ka ofruar asnjë provë me të cilën do të lirohet i njëjti nga borxhi i energjisë elektrike.

Baza e kundërshtimit të konsumatorit të theksuara në ankesë është se vendimi i DMK/ZRRE-së është i paligjshëm pasi që nuk është bërë një vlerësim i drejt i gjendjes faktike ku me këtë rast është bërë edhe refuzimi i kërkesës time për tu liruar nga borxhi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29 prill 2014 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEDS-it, si dhe dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit, dhe pas vlerësimit të gjitha këtyre shkresave ka vërejtur se DMK, ka vepruar konform dispozitave ligjore në fuqi me rastin e marrjes së këtij vendimi. Bordi i ZRRE-së ka konstatuar se konsumatori nuk ka



bashkangjitur në ankesën e tij asnjë dokument të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me të cilën e vërteton faktin se i njëjti është përfitues i skemës sociale.

Sipas nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji theksohet: *“konsumatorët kanë obligimin që të paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifën për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja”*.

Gjithashtu neni 5 paragrafi 2 nën-paragrafi 2.4 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji theksohet: *“furnizuesi duhet të faturtojë dhe të arkëtojë (mbledh) pagesat prej konsumatorëve, andaj në këtë rast konsumatori është i obliguar ti përmbush kushtet ligjore sipas kontratës që ka me furnizuesin për energji elektrike”*.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29.04.2014 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK\_V\_1094\_02\_14, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmimeve tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar